



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 63

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË
USHQIMIT, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Jeta Deda, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 06.02.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin 2 (dy) veprimtarive publike të kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, të cilat rezultojnë të paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 63

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për raportimin e veprimtarive publike”

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është ndalur këtë herë pranë të rinjve të shkollës së Mesme të Përgjithshme “Myslym Keta” Kombinat në Tiranë, me orët edukative ndërgjegjësuese, mbi elementë kryesorë të sigurisë ushqimore.

Link: <https://www.facebook.com/photo?fbid=492815716361837&set=pcb.492815763028499>

2. “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pranë nxënësve të shkollës 9-vjeçare “Memzotaj” në Kavajë. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka vijuar me Fushatën Kombëtare, me orë ndërgjegjësuese për sigurinë ushqimore, pranë shkollës 9 vjeçare “Memzotaj” në Kavajë.

Link: <https://www.facebook.com/photo?fbid=489588310017911&set=pcb.489588350017907>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 9.2.2023, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 14.2.2023, ora 2:38 PM, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit bën me dije se:

“Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, menjëherë në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 4, pika 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, sapo administroi shkresën nr. 3873 prot., datë 2.12.2022, me lëndë “Kërkesë për caktimin e personit të kontaktit”, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përcjellë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, caktoi si person kontakti për përmbushjen e këtyre detyrimeve zj. Eda Gazheli.

Ky informacion u përcoll elektronikisht si dhe zyrtarisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, brenda afateve të përcaktuara. Duke qenë se në shkresën e përcjellë nga KQZ, shprehimisht thuhej se “KQZ do t’ju dërgojë më pas, në adresën e e-mail të personit të kontaktit, link-un dhe udhëzimet përkatëse me qëllim hapjen e llogarisë së institucionit tuaj në ndërfaqen e internetit të KQZ-së për raportimin e veprimtarive publike nga ana juaj”, vazhdimisht kemi qenë të vëmendshëm për ta kontrolluar çdo ditë adresën e emailit të

zj. Gazheli, për ardhjen e emailit-it nga ana e KQZ-së, nëpërmjet së cilit do dërgoheshin kredencialet për t'u aksesuar në ndërfaqen e raportimeve, sikurse dhe udhëzimet përkatëse.

Më datë 30.1.2023, kemi kontaktuar me përgjegjës të juridik, pranë Drejtorisë së Ligjshmërisë, nëpërmjet telefonit dhe i'a kemi bërë me dije shqetësimin tonë, lidhur me mos aksesimin në ndërfaqe, për të përmbushur detyrimet ligjore të Institucionit tonë. Na u bë me dije se, email-i mund të ketë ardhur në folderin "Junk", ose "Spam", dhe në rast se ky email nuk ka ardhur, do ridërgohen të dhënat e personit të kontaktit, në adresën të cilën kemi vënë në dispozicion.

Deri më datë 9.2.2023, datë e cila përkon dhe me denoncimin e përcjellë nëpërmjet email-it tuaj nuk kemi patur kredenciale për të raportuar. Sa shpjeguar, ne jemi vënë sërish në lëvizje, duke dërguar email në adresën institucione@kqz.gov.al, për të kërkuar ndryshimin e personit të kontaktit nga zj. Eda Gazheli, në zj. Jeta Deda, e cila ushtron dhe funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Sa më sipër, kërkojmë mirëkuptimin tuaj në mospërmbushjen e këtij detyrimi, jo për shkak të mungesës së vullnetit të Institucionit tonë, por për shkak të pamundësisë për t'u aksesuar në ndërfaqen e dedikur nga ana juaj për këtë qëllim".

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkak të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Jeta Deda, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI